



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 29.9.2014,
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Sokol Krasniqi, Vlora Dumoshi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Abit Kastrati, Shiqeri Spahiu, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Bardha Dida - Rogova, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Kreshnik Ahmeti, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Lirak Çelaj, Shemsi Veseli, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Lirijeta Rexhepi, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Besa Rafuna, Imer Rusinofci, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo dhe Nenad Miladinoviqi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësuesit e KFOR-it.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Kuvendit.

Për këtë mbledhje propozoi këtë

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës;
2. Dhënia e betimit të anëtarëve të rinj të Kuvendit;
3. Propozimbuxheti për vitin 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2015-2017;
4. Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015;
5. Propozimrregullorja për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë ;
6. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, për vitin 2015;
7. Propozimvendimi për krijimin e ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking";

8. Propozimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës, në Komisionin komunal të aksionarëve, për NPL "Prishtina Parking";
9. Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues "Arbëria 3";
10. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve në ndërmarrjet publike komunale të Komunës së Prishtinës;
11. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Komunës së Prishtinës;
12. Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2014-2015;
13. Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Agim Gashi tha se pika e dymbëdhjetë "Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2014-2015", nuk përputhet me rendin e ditës, sepse mungon pjesa e dytë, përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Si informatë mungon, nuk kemi material, nuk e di a mund të shkojë kështu, apo nuk mund të shkojë, andaj vetëm po e tërheq vëmendjen rreth kësaj.

Lirak Çelaj propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës "Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, për vitin 2015", të tërhiqet nga rendi i ditës, dhe të diskutohet në njërin nga mbledhjet e radhës. Po ashtu tërhoqi vërejtjet rreth dërgimit të pikave shtesë për mbledhje, duke cekur se materiali për mbledhjen e Kuvendit duhet të na dërgohet një javë para seancës, e jo vetëm disa ditë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Gashi, ku shumica e të pranishmëve u pajtuan që ajo të diskutohet, pra vetëm sukcesi i nxënësve për përfundimit e vitit shkollor.

Për propozimin e dhënë nga z. Çelaj, që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, sqarime dha **Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës.

Pika e parë:

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe të mbledhjes urgjente.

Flamur Shala bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së gjashtë, duke thënë se gjatë formulimit të fjalisë lidhur me diskutimin tim, ka lëshime dhe devijime dhe nuk është paraqitur ashtu si është thënë. Devijime ka edhe në transkript, gjë që nuk është dashur të ndodh.

Kryesuesi tha se për shkak të disa problemeve teknike, incizimi i mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës nuk është bërë ashtu si duhet, andaj dhe transkripti nuk ka mundur të nxirret i plotë.

Feti Mehdiu, bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se për pyetjen e parashtruar, është dashtë të jetë e përshkruar edhe përgjigjja e cila është dhënë nga drejtori i Drejtorisë.

Me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit.

Pika e dytë:

Dhënia e betimit të anëtarëve të rinj të Kuvendit.

Anëtarët e rinj të Kuvendit, Bardha Dida - Rogova, Kreshnik Ahmeti dhe Shemsi Veseli, e bënë betimin para Kuvendit të Komunës.

Pika e tretë:

Propozimbuxheti për vitin e vitit 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore, për vitin 2015-2017.

Kryesuesi fillimisht i njoftoi të pranishmit se, në bazë të Qarkores buxhetore, të nxjerrë në mbështetje të Ligjit mbi financat publike dhe përgjegjësitë, ministri i Financave ka paraparë disa aktivitete, të cilat do t'i kryejë ekzekutivi i komunave për hartimin e projektbuxhetit, kufijtë buxhetor etj.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se ky propozimbuxhet paraqet synimet dhe vlerat tona, të cilat duam t'i prezantojmë dhe përfaqësojmë në Prishtinë dhe për Prishtinën, jo vetëm në vitin 2015, por edhe vitet në vijim. Për këtë propozimbuxhet është marr për bazë edhe Plani zhvillimor komunal, si dhe disa projekte të tjera.

Sami Hamiti, në emër të GP i LDK-së, tha se çështja e shpërndarjes së buxhetit, përveç këtij aspektit ligjor, duhet të analizohet, që është shumëdisiplinare, dhe duhet të merren për bazë shumë aspekte në hartimin e buxhetit. Ne e kemi analizuar në GP në formën e tillë qysh është, mirëpo pasi që vërejtjet dhe sugjerimet e GP të LDK-së nuk janë përfshirë në projekt, GP i LDK-së nuk do ta votoj këtë buxhet.

Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, tha se duke i pas parasysh të gjitha ato komente të cilat i kemi dhënë ne, ky buxhet nuk reflekton zhvillim të cilin ne ia dëshirojmë qytetit të Prishtinës. Duke i pasur parasysh këto parametra, këto kushte, Grupi i asamblistëve i PDK-së nuk do të votoj për miratimin e këtij buxheti, me qëllimin më të mirë që ky buxhet të përmirësohet dhe qyteti të zhvillohet ashtu si i ka hije.

Në emër të GP të LVV-së diskutoi Ylli Hoxha, Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, Ymer Rusinovci, në emër të GP të AAK-së, Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, Ibrahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, përfaqësues nga subjekti politik i PF-së, Gyneid Ustaibo, nga subjekti politik i KDTP-së, Nenad Miladinoviq, përfaqësues nga subjekti politik i LS-së, Agim Gashi, Sylejman Pireva, Shemsi Veseli, Kimet Zeqa, Flamur

Shala, Laura Zherka, Muhamet Selmani, Ajnishahe Azemi, Shefki Gashi, Hatixhe Latifi - Pupovci, Hatixhe Hoxha, Sadri Ramabaja, Mirlinda Sopi, Lirjeta Rexhepi, Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës dhe Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Propozimbuxhetin për vitin 2015 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Me njëzet e pesë (25) vota për, tetëmbëdhjetë (18) kundër dhe shtatë (7) abstenime, u miratua Propozimbuxheti për vitin 2015 dhe Korniza afatmesme buxhetore 2015-2017.

Pika e katërt:

Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, për vitin 2015.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit i njoftoi Shpend Ahmeti, duke shtuar se është një propozim që vjen nga GP i LVV-së, një paragraf, i cili i liron nga tatimi në pronë familjet e dëshmorëve, familjet e viktimave civile të luftës, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Lidhur me këtë ndryshim, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, dha një interpretim ligjor. Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, përkrahu miratimin e kësaj pike.

Islam Pacolli propozoi që të precizohet gjendja e vështirë ekonomike e këtyre përfituesve, pasi që ka numër të madh të kësaj kategorie dhe pastaj nuk mundet t'i përballojë Komuna.

Ibrahim Mehmetaj propozoi që në këtë rregullore, gjegjësisht në atë dispozitë, të ceket se përfitues janë edhe veteranët dhe invalidët e luftës.

Qendron Kastrati tha se si kërkesa e parë është me u bazuar në ligjin, që fatkeqësisht deri tash nuk është miratuar, ku veteranët e luftës nuk përfshihen në këtë ligj. Po ashtu përkrahi edhe kërkesën e z. Mehmetaj.

Këtë propozimrregullore e përkrahën edhe Feti Mehdiu, Visar Arifaj dhe Ajnishahe Azemi.

Kryesuesi tha se, në konsultim me Zyrën ligjore, lidhur me nenin 6 të kësaj rregulloreje, do të kërkojmë interpretim, por dhe konsultim me Ministrinë e Financave, që të riformulohet pastaj kjo dispozitë.

Me propozimin e dhënë, që të inkorporohet në tekstin final, njëzëri u miratua Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015.

Pika e pestë:

Propozimrregullorja për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë.

Agim Salihu theksoi se kjo rregullore përcakton çështjen e organizimit të brendshëm, të mbrojtjes, përparimit, promovimit dhe shfrytëzimit të Parkut të Gërmisë.

Agim Gashi propozoi që në vend të fjalës *vizitor* të jetë *qytetar*, pasi që në këtë rast është term më adekuat. Po ashtu duhet pasur parasysh edhe rrugën, e cila shkon në drejtim të fshatit Butovc, në mënyrë që ajo kategori e qytetarëve të lirohet nga pagesa për hyrje në park.

Sylejman Pireva propozoi që në nenin 11, pikat 3.8 dhe 3.9 të riformulohen më mirë.

Përkrahje për miratimin e kësaj pike dhanë edhe: Kreshnik Ahmeti, në emër të GP të LVV-së, Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, Rita Begolli, në emër të GP të AAK-së, Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, Brahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, në emër të subjektit politik PF dhe Shpend Ahmeti, Kryetari Komunës.

Me vërejtjet dhe propozimet e dhëna, me shumicë votash u miratua Rregullorja për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë.

Pika e gjashtë:

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, për vitin 2015

Kryesuesi tha se për hir të procesit, duhet të konstatohet se Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, e vitit 2011, me plotësime dhe ndryshime, mbetet ende në fuqi.

Pika e shtatë:

Propozimvendimi për krijimin e ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking"

Lidhur me këtë pikë, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, i njoftoi të pranishmit, duke cekur se arsyeshmërinë për themelimin e kësaj ndërmarrje e kam prezantuar në takimin me shefat e grupeve parlamentare dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, andaj konstatoj se kemi nevojë të krijojmë një model të menaxhimit të organizimit të parkingjeve në qytetin e Prishtinës, model i cili është treguar i suksesshëm në 17 kryeqendra të rajonit dhe Evropës. Ideja është që hapësirat ekzistuese të parkingjeve që janë në Prishtinë, të shfrytëzohen në mënyrë racionale, pra me idenë që të menaxhohen kërkesat, ndërsa për banorët e lagjeve të jepen në trajtim preferencial.

Për këtë pikë diskutuan: Sami Hamiti, Ylli Hoxha, Lirak Çelaj, Islam Pacolli, Rita Begolli, Kimet Zeqa, Abetare Fazliu, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo dhe Nenad Miladinoviqi.

Njëzëri u miratua vendimi për krijimin e ndërmarrjes publike lokale "Prishtina Parking".

Pika e tetë:

Propozimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës në Komisionin komunal të aksionarëve për NPL "Prishtina Parking" SH.A.

Për anëtarë të Komisionit komunal të aksionarëve për NPL "Prishtina Parking", nga radhët e anëtarëve të Kuvendit u propozuan **Sofije Bunjaku**, nga subjekti politik AKR dhe **Bardha Dida - Rogova**, nga subjekti politik LVV.

Njëzëri u miratua Vendimi për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës në Komisionin komunal të aksionarëve, për NPL "Prishtina Parking".

Pika e nëntë:

Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të vendimit për ndryshimin dhe plotësim të Planit rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë.

Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i njoftoi të pranishmit rreth procesit të revidimit me disa ndryshime dhe plotësime të Planit rregullues "Arbëria 3".

Ilir Gjinolli, përfaqësuesi i kompanisë projektuese "Urban Plus", bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar disa nga komponentet kryesore rreth revidimit të tij.

Lidhur me këtë pikë diskutuan edhe Muhamet Selmani, Agim Gashi, Sylejman Pireva, Laura Zherka, Mustafë Krasniqi, Hysen Durmishi (drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale), Hatixhe Latifi, Qëndron Kastrati, Kimet Zeqa, Ajnishahe Azemi dhe Brahim Mehmetaj.

Njëzëri u miratua Vendimi për lënien në diskutim publik të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues "Arbëria 3".

Pika e dhjetë:

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.

Nga radhët e subjektit politik LVV, për anëtar të Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", në vend të Fisnik Ismajlit u propozua Kreshnik Ahmeti.

Me njëzet (20) vota për dhe një (1) abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.

Pika e njëmbëdhjetë:

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Nga radhët e subjektit politik LVV, për anëtar në Komitetin për Arsim, Kulturë dhe Sport, në vend të Fisnik Ismajlit u propozuar Bardha Dida - Rogova, ndërsa për Komitetin për Shërbime Publike, në vend të Puhie Demakut u propozua Kreshnik Ahmeti.

Në Komitetin për Pronë, në vend të Feim Salihut nga radhët e subjektit politik LDK, u propozua Shiqeri Spahiu. Në Komitetin për Planifikim Urban, në vend të Ylli Hoxhës u propozua Nol Binakaj.

Me propozimet e dhëna, njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dymbëdhjetë:

Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2014-2015;

Për këtë informatë bëri një prezantim Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit. Lidhur me informatën diskutuan edhe Agim Gashi, në emër të GP të LDK-së, Ylli Hoxha, në emër të GP të LVV-së, Lirijeta Rexhepi, në emër të GP të PDK-së, Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, Besa Rafuna, në emër të GP të AAK-së, Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, Ibrahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, në emër të subjektit politik PF, Sadri Ramabaja, Mirlinda Sopi, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Hatixhe Pupovci dhe Ajnishahe Azemi.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit.

U konstatua se u përkrah Informata për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013/2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014/2015.

Pika e trembëdhjetë:

Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve;

Lidhur me Informatën për përfundimin e korrje - shirjeve, të pranishmit i informoi Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit Lokal.

Agim Gashi propozoi që pronarëve të tokave, bujqve, të mos iu jepet subvencionimi për farën dhe plehun, në çoftë se nuk i kanë dy hektarë tokë. Mos është ndoshta ky kriter që e ka caktuar një nivel tjetër.

Lidhur me çështjen e ndarjes së subvencioneve, si dhe disa çështje të tjera që ndërlidhen me fushën e ekonomisë, konkretisht rreth Sektorit të bujqësisë, sqarime të nevojshme dha **Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës së Prishtinës.

U konstatua se u përkrah Informata për përfundimin e korrje- shirjeve.

Pika e katërbëdhjetë:

Pyetje dhe përgjigje

Ajnishahe Azemi, në emër të anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kërkoi që të bëhet pagesa për anëtarët e këtij komiteti për mbledhjet që i mbajnë, me arsyetimin se është komitet shumë aktiv, por edhe për anëtarët e komiteteve të tjera, mbi bazën e rezultateve.

Merita Surkishi tha se në Komitetin për Shërbime Publike kam bërë një propozim, që në Parkun e Gërmisë të ketë siguri më të madhe për qytetarët e Prishtinës. Aty qytetarët paguajnë nga një euro për mirëmbajtje të parkut, por nuk ofrohet siguria e mjaftueshme për qytetarët.

Kam dhënë një propozim që, të paktën të shtunave dhe të dielave, kur frekuentimi i njerëzve është më i madh, me pas patrulla policore dhe autoambulanca.

Pyes drejtorin se çka është ndërmarr lidhur me këtë çështje? Por, edhe në Parkun e Qytetit po shpresoj se duhet të vlejë e njëjta gjë, për me pasur patrulla policore për shkaqe sigurie, sidomos për fëmijët që e frekuentojnë parkun e qyteti. Shpresoj se do ta kem përgjigjen.

Pika e pesëmbëdhjetë:

Të ndryshme:

Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se për shkak të kuorumit jo të plotë të Komisioni për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendbanimeve, kërkoj që komisioni të plotësohet me anëtarë të tjerë. U propozua që në vend të Bahtije Ukës, të caktohet Florina Rrahmani, ndërsa në vend të Mirlinda Sopit, të caktohet Remzi Pacolli.

Me propozimet e dhëna, njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Mbledhja mbaroi në orën 18:00.

**Procesmbajtës
Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi Jur. idil.**